



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:094530

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811013

KA.nr.590/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “H.G.” B.I, me seli në Suharekë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Farmaceutik, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit K-57-20 të datës 30.07.2020, me datë 27.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit “H.G.” B.I, me seli në Suharekë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë- Inspektorati Farmaceutik, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit K-57-20 të datës 30.07.2020.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me datë 10.08.2020 paditësi “H.G.” B.I, me seli në Suharekë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë- Inspektorati Farmaceutik, me seli në Prishtinë me kërkesëpadi për anulim të Vendimit K-57-20 të datës 30.07.2020.

Gjykata me datë 17.05.2024 caktoj dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor, ku mori pjesë pronari i BI H.G., ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, konform

nenit 41. të LKA-së, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 17.04.2024, ftesës nuk i është përgjigjur, ftesën nuk e ka arsyetuar.

Në fjalën hyrëse paditësi H.G. deklaroj se ka qenë koha e pandemisë në kohën kur është bërë inspektimi, gjoba e shqiptuar në vendim të datës 24.06.2020 i është shqiptuar pa të drejtë, dhe që sipas procesverbalit kur është kryer inspektimi, në barnatore ka qenë farmacisti zëvendësues dhe kjo gjë është konstatuar në procesverbal mirëpo pas një periudhe i njëjti ka pranuar vendimin me të cilin i është caktuar gjoba. Deklaroj se gjoba e shqiptuar është paguar me urdhër të përmbaruesit privat dhe deklaroj se nuk ka interes juridik për të vazhduar me kërkesëpadi prandaj tërhiqet nga padia e parashtruar. E paditura njoftimin për tërheqje të padisë e ka pranuar me datë 24.05.2024, nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e paditësit nga padia.

Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit për tërheqje të padisë, konform nenit 261 par 1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
Ka.nr.590/22, datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2020:094530
Datë: 12.06.2024
Numri i dokumentit: 05811013